

P. nr.792/2015

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,** Gjyqtarja **DIANA SINA,** me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit E. M. nga Gjakova, për shkak se ka kryer veprën penale, të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshem në Gjakovë, PP.nr.1375/2015 të datës 12.12.2015 në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datën **24.11.2016,** në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarit E. M., të dëmtuarës Përfaqësuesi i autorizuar i KEDS-Distrikti në Gjakovë, me dt.**25.11.2016** mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **E. M.,** nga i ati Sh. dhe e ëma S. e gjinisë S., i lindur me... në fsh. R. K. Gjakovë, e tani me banim në Gjakovë, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-atë i 6 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

### Ë s h t ë f a j t o r:

**Sepse:** Ndërmjet datës së pa vërtetuar e gjer me datën 29.01.2014 në shtëpinë e tij në rrugën “L. D.” në Gjakovë, me qëllim që ti sjell vetit pasuri në mënyrë të kundërligjshëm, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që në njëhisorin elektrik me nr.34584164 me anë të kabllor 5x2.5 është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, gjendje kjo e konstatuar nga komisioni i autorizuar KEDS-Distrikti në Gjakovë, me dt.29.01.2014,me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 1.283.28 Euro.

-me çka ka kryer veprën penale, të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,46,50,51,73, dhe nenit 320 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës.

### G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej **400.- (Katërqind)Euro,** të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti,** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **20 (Njëzet) ditësh,** duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës.**

Detyrohet I akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej **30 Euro,** në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara KEDS-Distrikti në Gjakovë, kompensimin e dëmit mund ta realizon në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë Aktakuzë PP.nr.1375/2015 të datës 21.12.2015, kundër të akuzuarit E. M. nga Gjakova, për shkak se ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së, dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu pasi lexoi aktakuzën bënë përmisimin e dispozitivit të aktakuzës në rreshtin e gjashtë ashtu që në vend të fjalës Distrikti në Prishtinë, duhet të jetë Distrikti në Gjakovë, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

Përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Prokurori i çështjes gjatë shqyrtimit gjyqësor në fjalën hyrëse deklaron, se në shkresat e lëndës kemi prova të mjaftueshme që i pandehuri E. M. ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-ës, kur e themi këtë bazohemi në provat e parashtruara në aktakuzë, siç është procesverbali mbi gjendjen e faktike me nr.0215610 të dt.29.01.2014, fatura mbi dëmin e shkaktuar të dt.07.02.2014, lidhur me këtë do të dëshmojnë edhe dëshmitarët K. I. dhe D. M. që të dytë punëtor të KEDS-Distrikti në Gjakovë, me të cilat do të vërtetohet fajësia e të pandehurit, prokurori i çështjes në fjalën përfundimtare deklaron, se mbetëm në tërësi pranë aktakuzës pasi që gjatë këtij shqyrtimi u vërtetua në tërësi gjendja faktike, pasi që të dy dëshmitarët elaburuan në tërësi mënyrën se si ka ardhur deri te keqpërdorimi i rrymës elektrike, me çka konstatohet se i pandehuri E. M. ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës, andaj kërkohet që i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe njëherit të obligohet në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

E dëmtuara Përfaqësuesi i autorizuar i KEDS-Distrikti në Gjakovë B. J. në fjalën hyrëse dhe fjalën përfundimtare deklaron, se e mbështesë në tërësi fjalën hyrëse dhe fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, si dhe parashtron kërkesën pasurore juridike, të cilën do ta realizon në kontestin civil.

I akuzuari E. M. në fjalën hyrëse deklaron, se nuk e ndij veten fajtor për veprën penale me të cilën akuzohem me arsyetim se ditën kritike kur dy punëtorët e KEK më kanë pritur në rrugë para derës së shtëpisë, në momentin kur unë kam dal prej shtëpisë të njëjtit kanë hyrë në shtëpinë time, aty e kanë takuar bashkëshorten time dhe vajzën, ma vonë ka ardh djali im B. nga shkolla, dhe në atë moment kanë shënuar procesverbalin në prezencë të djalit tim, pa qenë unë prezent, pasi më ka lajmëruar familja unë jam kthyer në shtëpi dhe i kam vërejt dy punëtorët e KEK-ut, kanë qenë edhe më shumë dhe njeri prej tyre K. I. më ka thënë ne e konstatuam se ti je duke e keqpërdorë rrymën por na trego se ku e ke lidhjen kryesore, deri sa i kam gjetur çelësat e dyqanit, i cili dyqan gjendet në oborrin e shtëpisë sime por hyrjen e ka në rrugën kryesore, unë kam dalë, kam hap dyqanin dhe kam treguar se ku është duke u furnizuar ajo kabllo të cilën punëtorët e KEK e kanë vërejte në oborrin e shtëpisë sime, e cila kabllo ka qenë e lidhur në prizën e dyqanit, ndërsa ora nuk ka qenë fare e prekur, punëtorët paraprakisht kishin shkullur kabllo që e kanë gjetur në oborrin e shtëpisë, prandaj e njëjta është këputur nga prizma, pasi punëtorët verifikuan këtë gjendje atëherë njeri prej tyre ka hyp në shtyllën elektrike dhe ka ndërpre rrymën elektrike të dyqanit, mandej të njëjtit ma kanë prezantuar procesverbalin, ku kishte qenë prezent djali im B., atëherë unë u revoltova në djalin tim dhe i thash pse e ke dhënë numrin e lejes së njoftimit kur unë nuk kam qenë prezent, pastaj unë kam bërë ankesë në KEDS dhe kam kërkuar që të bëhet ekspertiza që të verifikohet se a e kam keqpërdorë unë njehsorin elektrik, pas 1-2 muajve kanë ardh përsëri punëtorët e KEDS në kontroll, njërin e kam njohur ka qenë D. M. por personin tjetër nuk e di se kush ka qenë, dhe posa kanë ardh së bashku me mua kanë hyrë në dyqan, dhe të njëjtit kanë këputur bllokat e njehsorit elektrik të

dyqanit, kur unë i kam pyetur pse bëtë këtë veprim D. M. më ka thënë se duhet me i këput të gjitha kabllot në mënyrë që mos të dyshohet se është duke u keqpërdorur rryma dhe të njëjtin njehsor e kanë fotografuar, prandaj nga arsyet e lartë cekura unë nuk e ndij veten fajtor, për veprën penale me të cilën ngarkohem, ndërsa i njëjti në fjalën përfundimtare deklaroi, se unë nuk e ndij veten fajtor edhe pas përfundimit të procedurës së provave dhe i propozoi Gjykatës të më liroi nga përgjegjësia penale pasi që në asnjë provë nuk është vërtetuar se unë kam kryer këtë veprë penale me të cilën ngarkohem, shton se jam në gjendje të dobët materiale, nuk kam bukë me hëngër.

Pas procedimit të provave në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një, dhe pastaj në lidhje me njëra tjetrën, komfori nën 361 të KPPK-ës, Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike, si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, andaj me veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-ës, për të cilën veprë i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, pasi që në rastin konkret nuk ka gjetur asnjë rrethanë e cila kishte për ta përjashtuar përgjegjësinë e tij penale.

Këtë gjendje faktike, Gjykata vërtetoi nga procesverbali me nr.0215610 të datës 29.01.2014 të lëshuar nga KEDS-Distrikti në Gjakovë, nga fatura me nr.62/14 të dt.06.02.2014 të lëshuar nga KEDS-Distrikti në Gjakovë, nga fatura mbi dëmin e shkaktuar DGJ14HPO3543 datës 07.02.2014 të lëshuar nga KEDS-Distrikti në Gjakovë, nga foto dokumentacioni që bashkëngjiten në shkresat e lëndës, nga deklarata e dëshmitarëve punëtor të autorizuar të KEDS në Gjakovë, si dëshmitar okular të vendit të ngjarjes K. I. dhe D. M., të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit E. M. të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në bazë të shkresave tjera në lëndë, Gjykata gjen se këto prova ofrojnë bazë të mjaftueshme, të njëjtat vërtetojnë se i akuzuari në kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet.

Dëshmitari K. I. gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përgjigjur në pyetjen e Prokurorit deklaroi se me rastin e kontrollës të konsumatorit kam qenë unë së bashku me koleget D. M. dhe dy përcjellës A. U. dhe F. A. të cilët kanë qenë në cilësinë e auditimit të punës tonë në teren, të cilët janë punëtor pranë KEDS në Prishtinë, në bazë të dhënave nga terreni për personat që është dyshuar për keqpërdorim të rrymës, kemi shkuar në shtëpinë e E. M., fillimisht ka dalë bashkëshortja e tij, i kemi treguar se jemi shërbimi i kontrollës, dhe kemi kërkuar se a është dikush prej meshkujve në shtëpi, na ka thënë se për momentin nuk është askush, nga ajo kemi kërkuar që të thirr burrin e saj, kemi prit pak kohë, ka ardhë djali i tij nuk më kujtohet emri, edhe atij ju kemi prezantuar si punëtor të shërbimit të kontrollës, i njëjti na ka thënë urdhëroni dhe kryeni punën e juaj, dhe në prezencën e tij kemi hapur njehsorin e shtëpisë, e kemi bërë qyqjen e njehsorit, pasi e kemi bërë qyqjen e njehsorit, kemi konstatuar se në shtëpinë e tij ka energji elektrike edhe pse e kemi qyqur njehsorin, kemi kërkuar me na shoqëruar brenda në shtëpi se kah njehsori po e merr këtë furnizim të energjisë, një pjesë e shtëpisë së tij është e rrethuar me xhama dhe të njëjtën e shfrytëzon si sallon të ndejës, djali i tij na ka qel derën, kemi hyrë brenda dhe kemi gjetur kabllon e cila e furnizonte shtëpinë me energjinë elektrike ku kemi konstatuar keqpërdorimin e energjisë elektrike, kemi kërkuar me hy brenda në shtëpi dhe me i regjistruar pajisjet elektrike që shpenzojnë energjinë elektrike, të njëjtat i kemi regjistruar dhe i kemi shënuar në procesverbalin e dt.29.01.2014, dhe kemi shënuar dhe fuqinë e ngarkesës së pajisjeve të shfrytëzuara, pastaj ka ardhur E. M. me një taksì, nga ai kemi kërkuar shënimet e tija personale, i njëjti ka hyrë në shtëpi për të marrë dokumentacionin, kemi prit mbi një orë por ai nuk ka dalë prej shtëpisë, kemi konstatuar pikën kyçëse se ku ishte duke marrë energjinë, prej shtëpisë së tij e ka një lokal që ka shërbyer si furrë, dhe në qosh të ullukut kishte marrë furnizimin, dhe shërbimi i kontrollës ka si obligim kur ta bënë konstatimin e keqpërdorimit të konsumatorit nuk guxon të largohet nga vendi i ngjarjes pa bërë eliminimin e keqpërdorimit, pasi nuk kishim pajisje për ta qyqur lokalin, kemi kërkuar asistencë nga ekipet e rrjetit të kryesuar nga H. A., të njëjtit kanë ardhë në vendin e ngjarjes mirëpo fillimisht djali i tij nuk ka lejuar me qyq, unë nga ai kam kërkuar

që urdhëresa duhet të zbatohet atëherë duhet me e thirr policinë për ndihmë, mirëpo kemi arrit që të kryejmë punën pa ndërmjetësimin e policisë, kështu pa prezencën e policisë është qyqur rryma e lokalit prej ku u furnizonte lidhja ilegale, shton se kemi konstatuar se keqpërdorimin konsumatori E. M. e ka bërë me një kablo 5x2.50, të cilën e ka marr nga lokali para njehsorit elektrik, respektivisht ky nuk është regjistruar në njehsorin e lokalit të tij, dhe e njëjta kablo ka vazhduar në shtëpinë e tij me këtë kablo ka furnizuar pajisjet e shënuar në procesverbal, do të thotë shpenzimi i energjisë elektrike nuk është regjistruar në njehsorin elektrik në dyqanin e tij dhe as në shtëpinë e tij, shton se konsumatori E. M. pas konstatimit të procesverbalit ka qenë shumë agresiv, ka eskaluar situata prandaj jemi detyruar që të tërhiqmi nga shtëpia e tij, në pyetjen tjetër të prokurorit të çështjes dëshmitari deklaroi se në oborrin e tij apo në shtëpinë e tij nuk ka pasur fare gjeneratorë ditën kritike. Në pyetjen e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjakovë, B. J. dëshmitari K. I. deklaroi se konkretisht kablloja 5x2.50 ka qenë e lidhur në qoshkun e lokalit, në qoshkun e ullukut të ujit gjë që mund të argumentohet edhe me fotot që bashkëngjiten në shkresat e lëndës në momentin kur ne kemi tërheqë dhe e kemi këputur, në pyetjen e të akuzuarit dëshmitari K. I. deklaroi se ishte e pamundur që të qyqet lidhja ilegale nga tavani i lokalit pasi tavani ishte i naltë dhe sjelljet e të akuzuarit kanë qenë jo korrekte, prandaj kemi marr këshilla prej udhëheqësit të KEDS që të tërhiqemi në rrugë dhe jemi detyruar që qyqjen të bëjmë në shtyllën elektrike që ka qenë në rrugë, në pyetjen tjetër i njëjti deklaroi se nuk është e vërtetë se i akuzuari personalisht ka hapur derën e lokalit që ne të kontrollojmë sepse fillimisht ai fare nuk ka qenë në shtëpi, kur ka ardh më vonë ka hyrë në shtëpi dhe nuk ka dal prej shtëpisë deri sa ne jemi detyruar që qyqjen e rrymës elektrike ta bëjmë në shtyllën elektrike.

Dëshmitari D. M. gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor në pyetjen e prokurorit të çështjes deklaroi, se ditën kritike unë së bashku me kolegun K. I. dhe dy punëtor të auditimit nga Prishtina në nivel qendror të cilët kanë monitoruar punën tonë kemi shkuar në kontroll rutinore në shtëpinë e konsumatorit E. M. për të verifikuar keqpërdorimin e rrymës elektrike në bazë të urdhëresës së koordinatorit – shefit të KEDS te konsumatori tek të cilët dyshohet se është keqpërdorë rryma elektrike siç është në rastin konkret, kur kemi shkuar në shtëpinë e konsumatorit E. M. në fillim ka dal bashkëshortja e tij, e kemi njoftuar se jemi shërbim i kontrollës, kemi kërkuar se a është dikush prej meshkujve në shtëpi, ka thirr dhe ka dal djali i tij, edhe atij i kemi treguar qëllimin e shkuarjes sonë, dhe me lejen e tij kemi filluar kontrollën në shtëpinë e konsumatorit E. M., në fillim kemi qyq daljet e njehsorit elektrik në shtëpinë e konsumatorit E., dhe kemi vazhduar kontrollën brenda në shtëpi, aty kemi hasur një kablo furnizuese 5x2.50 me tri siguresa ku kishte tension të rrymës, edhe pse ne e kishim qyqur më parë njehsorin elektrik të shtëpisë, kemi dalë jashtë se kemi kontrolluar kabllon kryesorë prej shtyllës e deri te njehsori, e njëjta ka qenë në rregull, na u desh që ta vërtetojmë se nga vjen rryma elektrike e kabllos të cilën e hasëm në shtëpinë e tij, në oborrin e tij konsumatori kishte një lokal e shfrytëzonte si furrë, dhe kablloja të cilën konstatuam se kishte rrymë në shtëpinë e tij, ishte nën tokë dhe vazhdonte deri në qoshkun të ullukut të lokalit dhe vazhdonte deri në tavan të lokalit, ne kërkuam nga djali të na hap lokalin, ai na hapi lokalin, ne hymë në lokal dhe e ndërpremë rrymën e lokalit në ndërpres, në kablo jashtë prapë kishte rrymë, e kam fjalën për kabllon që vinte prej shtëpisë vazhdonte në qoshkun e ullukut dhe në kulmin e dyqanit, ne kemi kërkuar nga djali i tij që të hypim në tavan dhe ta vërtetojmë se ku është e kyçur ajo kablo, por i njëjti nuk na ka lejuar, pastaj ka ardh konsumatori E. M. dhe ka hyr brenda në shtëpi, nuk ka dalë nga shtëpia, ne kemi kërkuar që ti regjistrojmë pajisjet elektrike të cilat kanë qenë në shtëpi, por djali na ka thënë ta pyes babën dhe ka hyr brenda, pastaj djali ka dal dhe na ka lejuar që të hymë brenda dhe ti regjistrojmë pajisjet elektrike, të cilën punë e kemi bërë dhe i kemi regjistruar në procesverbal, për shkak se nuk na ka lejuar që të hypim në tavan, punëtorët e auditimit kanë kërkuar ndihmë nga policia, të njëjtit nuk kanë ardh, nuk e di arsyen sepse ata kanë biseduar, dhe më vonë kemi thirrë ekipin e qyqjes në kuadër të KEDS, dhe e kemi qyq rrymën e lokalit në shtyllën elektrike në mënyrë që të eliminojmë keqpërdorimin, shton se për shkak se konsumatori E. kishte bërë një ankesë në KEDS – në Prishtinë, lidhur me kontrollën e parë, prandaj unë së bashku me dy auditor të kontrollit në nivel qendror të Kosovës, kemi shkuar në shtëpinë e tij për të bërë edhe një kontroll, kemi bërë kontrollin

e njehsorit të shtëpisë së tij, ku i njëjti ka qenë prezent, kam shkuar menjëherë te kabloja të cilën e kam vërejt herën e parë, e njëjta ka qenë po në të njëjtin vend në shtëpi brenda, por jashtë nuk ka qenë, auditorët e vërejtën kabllon por rrym nuk ka pas. Në pyetjen e të akuzuarit E. M. dëshmitari D. M. deklaroi, se nuk është e vërtetë se kur i akuzuari ka ardh nga qyteti kinse K. I. i ka thënë se procedura është kryer, por ai duhet me tregu vetëm se ku është kyçja ilegale, sepse kur i akuzuari ka ardh nga qyteti në shtëpi ka hyrë brenda në shtëpi dhe nuk ka dalë, mirëpo në momentin kur ne kemi hipur në shtyllën elektrike i akuzuari ka dal nga shtëpia dhe me ton të lartë ka bërtit që mos ta qkyqim nga rryma, është krijuar një situatë jo e mirë ku i akuzuari ka qenë shumë nervoz dhe pastaj i njëjti ka hyrë në shtëpi, shton se nuk është e vërtetë që i akuzuari ka hapur dyqanin që gjendet në oborrin e shtëpisë së tij, por dyqanin e ka hapur kur është bërë kontrolli dhe dytë në bazë të ankesës së të akuzuarit, si dhe shton se nuk është e vërtetë se ne kemi këputur bllokat e njehsorit elektrik të lokalit kur kemi qenë për kontroll herën e dytë sipas ankesës së të akuzuarit.

Gjykata i ka vlerësuar dhe analizuar veç e veç të gjitha provat e pastaj duke i ndërlidhur me njëra tjetrën të nxjerra gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dëshmia e dëshmitarëve okular të vendit të ngjarjes, personat zyrtar të KEDS-Distrikti në Gjakovë, në cilësinë e personave zyrtarë të kontrollës K. I. dhe D. M. të cilat deklarata janë në përputhshmëri të plotë me njëra tjetrën në mënyrën e përshkrimit të veprës penale të kryera nga ana e të akuzuarit E. M., të cilët në mënyrë të hollësishme dhe shumë të kjart sqarojnë se ditën kritike sipas detyrës zyrtare kanë qenë në kontroll të shtëpisë së konsumatorit E. M. së bashku me dy përcjellës punëtor të auditimit në Prishtinë A. U. dhe F. A., të cilët kanë qenë në cilësinë e auditimit të punës në teren, dhe të njëjtit kanë konstatuar se i akuzuari E. M. ka keqpërdorë shfrytëzimin e rrymës elektrike me një kablo 5x2.50 i lidhur direkt në rrjetin elektrik, duke mos regjistruar shpenzimin e energjisë elektrike, të cilën e ka marr nga lokali që ndodhet në oborrin e shtëpisë së tij para njehsorit elektrik, ku rryma e shpenzuar me këtë kablo nuk është regjistruar në njehsorin elektrik të dyqanit e as në njehsorin elektrik të shtëpisë së tij, e njëjta kablo ka vazhduar në shtëpinë e tij i cili me këtë kablo ka furnizuar pajisjet elektrike të shënuara në procesverbal, do të thotë shpenzimi i energjisë elektrike nuk është regjistruar në njehsorin elektrik, prandaj sipas detyrës zyrtare të njëjtit kur kanë konstatuar këtë keqpërdorim e kanë qkyqur njehsorin elektrik nga rryma në shtyllën elektrike, pasi që konsumatori E. M. ka qenë shumë agresivë dhe nuk ka lejuar që të ndërprehet rryma elektrike në tavanin e lokalit, aty ku është bërë lidhja jo legale, nëpërmes kabllit 5x2.50, këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar edhe nga procesverbali me nr.0215610 të dt.29.01.2014 të lëshuar nga KEDS-Distrikti në Gjakovë, nga fatura mbi dëmin e shkaktuar të dt.07.02.2014, nga foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera në lëndë, andaj Gjykata në bazë të këtyre provave të administruara ka konstatuar se me të vërtetë i akuzuari E. M. ka kryer veprën penale të vjedhjes të shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-ës.

Gjykata i ka vlerësuar dhe analizuar edhe pretendimet e të akuzuarit i cili nuk e pranon fajësinë gjatë shqyrtimit gjyqësor, me arsyetim se nuk ka keqpërdorë rrymën elektrike përmes një kabllit siç deklaruan dëshmitarët – punëtorët e KEDS që kanë qenë në vendin e ngjarjes, sipas tij është e vërtetë që të njëjtit kanë gjete një kablo elektrike e cila ka qenë e lidhur në prizën e dyqanit i cili ka qenë i lidhur me gjeneratorin e shtëpisë së tij, sipas tij kjo kablo i ka shërbyer që të lidhet me gjeneratorin e shtëpisë e jo për të keqpërdorë rrymën elektrike, në bazë të kësaj Gjykata ka konstatuar se pretendimi i tillë i të akuzuarit është i pa bazuar, dhe i pa argumentuar me asnjë provë apo dëshmi, por konsideron vetëm përpjekjet e të akuzuarit për të ikur përgjegjësisë penale, sepse me të gjitha provat e administruara e pastaj të ndërlidhura me njëra tjetrën, nga dëshmia e dëshmitarëve K. I. dhe D. M. si persona zyrtar të KEDS, si dëshmitar okular të vendit të ngjarjes, gjykata vërteton se në shtëpinë e tij fare nuk ka pasur gjenerator, siç deklaroi i akuzuari E. M. kinse punëtorëve të KEDS ju ka treguar gjeneratorin, por ditën kritike nuk e ka pasur në funksion, andaj gjykata në bazë të provave të administruara ka vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjatë caktimit dhe matjes së dënimit në kuptim të dispozitës së nenit 73 të KPRK-ës, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat si ato rënduese, dhe lehtësuese të cilat ndikon në llojin dhe lartësinë e dënimit, pati parasysh peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, rrethanat në të cilat është kryer vepra, ndërsa si rrethana lehtësuese maur sjelljet e tij para kryerjes së veprës penale dhe pas kryerjes së saj, mos dënushmërinë e tij të mëparshme, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej **400.- (Katërqind)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor është marrë komfor nenit 450 par.2, nën parg.2.6 të KPPK-ës.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.792/15 më datë 25.11.2016**

**Sekretarja juridike,  
Lamije Kuqi**

**Gj y q t a r j a  
Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.